

-S.T.I.M.P
-14.02.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE



Korçë, me 09.02.2022

SHPLLJE VENDIMI

Drejtuar : Njesine Administrative Libonik Bashkia Maliq

Per: shtetasin : Ledjan Lefter Shkembi me adrese
fshati Shkoze Njesia Administrative Libonik Bashkia Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil
nr. 1023 dt. 13.12.2021 per t'u afishuar nga ana Juaj
njoftimi me shpallje me afat 20 ditore, pasi deftesa e
komunikimit eshte kthyer me shenimin : " larguar " dhe
pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me
vule e firme, ne gjykate.

KANCELARE
Lubiana KINOLLI



U afishua sot ne date -----

Ne Njesine Administrative Libonik Maliq

Nenpunesi _____
(emer, mbiemer, firme)

M. Post
15.02.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. 21234-00534-41-2020 (261/949) Regj.
Datë regjistrimi 03.06.2020

Nr. 41-2021-4063 (1023) VENDIMI
Datë vendimi 13.12.2021

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e përbërë prej:

Gjyqtare: **LULJETA KOLE**

Asistuar nga sekretare Adriana Fero, në Korçë, sot në datë 13.12.2021, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që i përket:

PADITËS: Hamdi Petriti, i biri i Mustafa dhe Satlihan, datelindja 28.03.1957, lindur dhe banues ne Maliq, me adrese: lagjja nr.2, banese private “Internet Klodi”.

I PADITUR: Ledjan Shkëmbi, i biri i Lefter dhe Aferdita, datelindja 10.02.1994, lindur dhe banues ne Shkozë, Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, gjykuar ne mungese.

OBJEKTI: Shperblim demi

Baza ligjore: Neni 32 i K.Pr,Civile dhe 608 i K.Civil

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të paditesit dhe ne mungese te te paditurit, eshte kërkuar:

Paditësi: pranimin e padisë duke u detyruar i padituri të paguajë në favor të tij shumën 1.500.000 lekë që përfaqson vlerën e dëmit të shkaktuar nga demtimi i baneses në pronësi të tij.

I padituri: Ne mungese

Gjykata, pasi dëgjoji palët dhe analizoi provat e marra në gjykim,

VËREN

Me padinë drejtuar gjykatës, paditësi ka kërkuar detyrimin e të paditurit ta shpërblejë me vlerën e dëmit të shkaktuar nga demtimi i baneses në pronësi të tij.

Nga deklaratimet e paditesit dhe provat e mara gjatë hetimit gjyqësor, rezultoi se jemi para faktit si më poshtë:

- Paditesi Hamdi Petriti rezulton të jetë pronar i pasurisë me nr.1325/1, regjistruar në ASHK Korçë, ZK 3395, vol.1, faqe 202, e llojit truall+arë, me sipërfaqe totale 500 m², nga e cila sipërfaqe trualli 350 m² dhe ndërtesa 102 m², ndodhur në fshatin Shkozë.

- Në datë 03.12.2016. ndërtesa e sipërcituar që është banesa e shtetasit Hamdi Petriti, është djegur me zjarr dhe për këtë fakt ky shtetas ka bërë kallëzim në polici.

- Në lidhje me këtë ngjarje, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, mbi bazën e materialeve kallëzues të dërguar nga Komisariati i Policisë Maliq ka regjistruar në datën 05.12.2016 procedimin penal Nr.1344 të vitit 2016, për kryerjen e veprës penale të "Shkatërrimit të pronës me zjarr" të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal.

Nga aktet e këtij procedimi penal rezulton se në datë 03.12.2016, rreth orës 14.00, është njoftuar Komisariati i Policisë Maliq në fshatin Shkozë të Bashkisë Maliq kishte rënë zjarr në banesën e shtetasit Hamdi Petriti të ndodhur në këtë fshat. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes ka rezultuar se banesa ishte shtëpi private me dy dhoma dhe një kuzhinë e cila është djegur plotësisht bashkë me sendet e luajtshme të ndodhura brenda në këtë banesë. Në oborrin e banesës është konstatuar i djegur dhe një motor të markës "Honda" 97cc.

Në bazë të aktit të ekspertimit teknik-zjarr me Nr.44, datë 19.12.2016 të Drejtorisë të MZSH pranë Bashkisë Korçë, ka rezultuar se shkak i venies së zjarrit në banesën e shtetasit Hamdi Petriti është venie nga jashtë me qëllim. Në bazë të aktit të ekspertimit vlerësues të demit të shkaktuar të datës 20.12.2016, rezulton se dëmi i shkaktuar nga vënia e zjarrit me qëllim në banesën dhe motorin e shtetasit Hamdi Petriti është në vlerën 750.000 leke.

Nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se personi që i ka vënë zjarrin banesës së shtetasit Hamdi Petriti është shtetasi Ledjan Shkëmbi me banim në fshatin Shkozë, i cili dhe e ka pranuar këtë fakt. Ai ka deklaruar se zjarrin e kishte vënë i nervozuar pasi kishte parë shtetasin Hamdi Petritin të ndodhur në oborrin e banesës së tij bashkë me nënen e tij të cilën e kishte kapur për krahu dhe i thoshte fjale të papërshtatshme. Ka dashur ta kapë këtë shtetas po ai ka ikur me vrap. Në këto kushte, ka marrë një shishe benzine dhe i ka djegur motorin e ndodhur në oborrin e banesës së tij dhe vetë banesën e shtetasit Hamdi Petriti.

Në perfundim të hetimit në lidhje me këtë procedim penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkalles së Parë Korçë ka marrë të pandehur shtetasin Ledjan Shkëmbi duke e dërguar çështjen në gjykatë - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 94 datë 14.02.2017, e ka deklaruar fajtor të pandehur Ledjan Shkëmbi për veprën penale të "Shkatërrimit të pronës me zjarr" të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal dhe e ka dënuar atë me 200.000 leke gjobe.

Në lidhje me faktin si më sipër, paditësi deklaroi se ai provon faktin që i është shkaktuar dëm pasuror nga djegia e banesës. Duke qenë se objekti ndërtesa është demtuar në mënyrë të paligjshme nga i padituri, ky i fundit duhet ta shpërblejë me vlerën e demit të shkaktuar.

Eksperti vlerësues Pandi Treska, paraqiti aktin e ekspertimit nëpërmjet të cilit ka dhënë mendimin si vijon:

Objekti si pjesë e pasurisë 1325/1 ndodhet në një zonë të preferuar të fshatit Shkozë. Është një nga zonat, ku sot ka aktivitete të ndryshme bujqësore e blegtorale bletërritjeje dhe një zonë e qete me ndërtime një deri dy kate të tipit rezidencial. Ndertimi i këtij objekti është realizuar rreth viteve 60-70, me konstrukcion mur guri dhe pak tulle, mbuluar me çati tjegulla vendi. Ndertesa është e formës 1 kat i cili është një kat normal banimi.

Nga analiza qe i behet kesaj dispozite, duket qarte se e drejta civile si kusht per lindjen e detyrimeve nga shkaktimi i demit jashtekontraktor kerkon konkurimin e disa kushteve se bashku. Duke i analizuar ne teresine e tyre provat e marra gjate gjykimit dhe duke mbajtur parasysh nenin 608 te K.Civil, gjykata arrin ne perfundimin se ne rastin konkret konkurojne bashkarisht te kater kushtet e parashikuara nga ligji per lindjen e detyrimit nga shkaktimi i demit, perkatesisht:

-ekzistenca e demit, qe ne rastin konkret ka te beje me faktin se si rezultat i venies se zjarrit nga i padituri, eshte demtuar banesa e shtetasit Hamdi Petriti;

-ekzistenca e paligjshmerise se veprimit apo mosveprimit, qe konsiston ne veprimet e shkaktuesit te demit pasi ato objektivisht kane sjelle cenim te drejtave pasurore te paditesit, per faktin e djegies e si rrjedhim demtimit te baneses se paditesit;

-ekzistenca e fajit eshte e dukshme dhe e vertetuar me teresine e akteve procedurale te cilave iu eshte referuar edhe organi procedues ne ngritjen e akuzes, e me pas me vendimin gjyqesor me te cilin eshte deklaruar fajtor i pandehuri Ledjan Shkëmbi ne lidhje me faktin e kunderligjshem qe lidhet me ngjarjen e dates 03.12.2016, qe ka te beje me djegien e baneses se shtetasit Hamdi Petriti;

-ekzistenca e lidhjes shkaksore midis faktit te paligjshem dhe demit te ardhur rezulton gjithashtu i qarte, pasi demtimet e shkaktuara ne pronen e paditesit, kane si shkak veprimet ne kundershtrim me ligjin te te paditurit, qe eshte personi qe i ka vene zjarrin baneses.

Bazuar ne faktin si me siper, paditesi ka legjitimim aktiv ne ngritjen e kesaj padie, pasi eshte personi qe i eshte demtuar prona

Po ashtu pala e paditur ka legjitimimin pasiv pasi eshte personi qe ka shkaktuar kete dem.

Nga sa u analizua më sipër, arrihet ne konkluzionin se paditësit i është shkaktuar dëm pasuror, i cili ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve të kundraligjshme dhe me faj të të paditurit, ndaj ne keto kushte padia duhet të pranohet.

Përsa i perket shpenzimeve gjyqesore, rezulton se paditesi ka parapaguar tarifën mbi aktet prej 1% të vleres se padise ne shumen 15.000 leke, si dhe shpërblimin e ekspertit ne masen 48.000 leke. Ne kushtet e pranimit te padise, keto shpenzime i ngarkohen te paditurit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar nenin 306-310 të K.Pr.Civile dhe 608 e 609 te K.Civil,

VENDOSI

1. Pranimin e kerkesepadise.
2. Detyrimin e te paditurit Ledjan Shkëmbi per te shperblyer paditesin Hamdi Petriti per vleren e demit pasuror ne lidhje me demtimin e baneses, ne vleren prej 1.500.000 (nje milion e peseqind mije) leke.
3. Shpenzimet gjyqesore ne masen 63.000 (gjashtedhjet e tremije) leke, te parapaguara nga paditesi, i ngarkohen te paditurit.

4. Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për këtë vendim gjyqësor që përbën titull ekzekutiv në momentin që vendimi merr formë të prerë.
5. Kunder vendimit mund të behet ankim në gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 diteve nga nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot në Korçë, me datë 13.12.2021 ora 14:18

**SEKRETARE
ADRIANA FERRO**



**GJYQTARE
LULJETA KOLE**



Objekti është i mirembajtur duke pasur një amortizim normal në masë të zakonshme. Objekti është me tavan dhe mure të suvatuar me suva bashkekohore. Ambjentet e tij ishin të pershtatura për një jetesë normale me të gjitha kërkesat që shtrihen për një jetesë të tillë. Të gjitha dyert dhe dritaret janë cilësore dritaret dhe dyert janë të një cilësie të lartë druri. Suvatimet e jashtme janë me llaç çimento në formë fugature në mur guri radhore. Instalimet elektrike dhe ato hidrosanitare ishin të reja dhe bashkekohore. Prona është e rrethuar me mur në formë avllie dhe komunikimi me jashtë realizohet nepermjet një porte druri të zakonshme..

Prona ndertese ka një sipërfaqe prej 102 m², orientimi i saj është nga ana jug-lindja. Sipërfaqja ndertimore është 102 m² 1 kat.

Për sa thame me lart: Duke marrë parasysh faktorët: pozicionin e vendndodhjes së objektit, amortizimin e

objektit, vitin e ndertimit, investimet e kryera në të etj, duke u mbështetur në Metoden e Krahasimit të Drejtperdrejte dhe në Metoden e Kostos Reale për pronën arrijme në konkluzionin e mëposhtem:

Per llogaritjen e objektit sipas metodave se mesiperme kemi:

Çmimi për njësi të kësaj ndertese duke marrë parasysh faktorët e mesiperme objekti është ndertese rezidenciale e tipit normal ku vlera ndertimore e tij për m² para vitit 2016 për fshatin e barabarte me 70 % të çmimit të ndertesës për qytetin është 28 000 lek/m².

Si përfundim Vlera e ndertesës është: 102 m² x 1 kat = 102 m² kat i rregullt pra:

102 m² x 28 000 lek/m² = 2.856.000 leke.

Vlera e ndertesës duke zbritur amortizimin e saj prej 40 - 60 %, është = 1.500.000 leke.

Gjykata, pasi dëgjoi palët, analizoi provat e marra në gjykim dhe mori mendimin e ekspertit, çmon se mosmarrëveshja rrjedh nga marrëdhëniet jashtëkontraktore dhe shkak i ngritjes së padisë është e drejta e paditësit për tu dëmshperblyer për shkak të dëmit që i është shkaktuar nga djegia e ndertesës prone e tij, e ndodhur në fshatin Shkozë, me sipërfaqe 102 m², pjesë e pasurisë me nr.1325/1.

Gjendja që i kundërvihet kësaj të drejte, ka të bëjë me faktin që i padituri nuk ka pranuar të shpërblejë paditësin për dëmin që i është shkaktuar nga djegia e banesës. Objekti i padisë është detyrimi të paditurit Ledjan Shkëmbi të shpërblejë paditësin me vlerën e dëmit të shkaktuar nga djegia e banesës.

Fillimisht vlera e dëmit është kërkuar në shumën 750.000 lekë referuar përlogaritjeve të kryera gjatë hetimit në lidhje me këto çështje.

Bazuar në aktin e ekspertimit të përgatitur nga eksperti vlerësues i caktuar nga gjykata, pala paditëse kërkoi shtimin e objektit të padisë, duke kërkuar shperblimin e dëmit nga i padituri në masën 1.500.000 leke. Kjo kerkese është pranuar nga ana e gjykates bazuar në nenin 5 e 185/2 të K.Pr.Civile, dhe duke qene se shtesa e objektit të padisë është bere në mungese të të paditurit, gjykata në base të nenit 185/3 të K.Pr.Civile i ka komunikuar të paditurit këto ndryshim.

Shkaktimi i dëmit është një marrëdhënie detyrimi jashtëkontraktor, e parashikuar nga Neni 608 i K.Civil, i cili percakton se "Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkaktonte tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shperblejë dëmin e shkaktuar.

Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira".

Kjo padi eshte paraqitur ne gjykate ne date 23.12.2020 dhe nepermjet shortit i eshte caktuar per gjykim gjyqtares Ariola Kristo. Pas largimit te kesaj gjyqtare nga detyra, me urdherin nr.88 Prot. date 04.10.2021 te Zv.Kryetares se Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçë, ceshtjet e gjyqtares Ariola Kristo jane rihedhur ne short dhe kjo çështje i eshte caktuar per gjykim ketij trupi gjykues.

Gjykata pasi u njoh me aktet e dosjes, konstatoi se nga ana e gjyqtares Ariola Kristo jane kryer veprimet paraprake konform neneve 158, 158/a e 158/b te K.Pr.Civile, eshte realizuar seanca e veprimeve pergatitore, dhe eshte kaluar ceshtja per shqyrtim ne seance gjyqesore, ku jane degjuar palet e jane administruar provat, eshte diskutuar akti i ekspertimit, eshte kerkuar nga paditesi te behet shtese e objektit te padise, e me pas eshte shtyre seanca gjyqesore per t'iu komunikuar te paditurit ne mungese shtesa e objektit te padise. Seanca gjyqesore e caktuar per kete qellim nuk eshte zhvilluar per shkak te mungeses se gjyqtares.

Ne nenin 181/2 te K.Pr.Civile parashikohet se: *“Kur per shkaqe te perligjura, ndryshon perberja e trupit gjykues, anetari ose anetaret e rinj duhet te rjhen me permbajtjen e procesit gjyqesor. Anetari ose anetaret e rinj mund te kerkojne qe hetimi gjyqesor te perseritet pjeserisht ose teresisht”*. Pra, sipas kesaj dispozite, gjykimi vijon ne momentin procedural ku eshte lene, por gjyqtari i ri mund te kerkoje pjeserisht ose teresisht hetimin gjyqesor.

Bazuar ne dispoziten e mesiperme, pasi u njoh me ceshtjen dhe permbajtjen e ketij procesi gjyqesor, gjykata cmoi se nuk kishte vend per perseritjen e ndonje veprimi paraprak apo veprimi procedural te kryer nga gjyqtarja ne vijim te shqyrtimit te kesaj ceshtje ne seance gjyqesore, dhe gjykimi duhet te vazhdonte ne momentin ku ishte lene pas pranimit te kerkeses se paditesit per shtese te objektit te padise.

Për të provuar pretendimet e ngritura në padi, paditësi paraqiti me cilësinë e provave aktet si vijon:

- Akti i marrjes se tokes ne pronesi nr.21769, date s'ka;
- Vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçë nr.94, date 14.02.2017;
- Procesverbali i séances gjyqesore date 14.02.2017 qe i perket gjykimit ne perfundim te te cilit eshte dhene vendimi i mesiperm;
- Konkluzione perfundimtare te prokurorit ne procesin penal;
- Shkrese e ZVRPP Korçë nr.2459 prot, date 27.04.2017;
- Fotografi e objektit bashkengjitur vertetimi i Kryeplakut te fshatit Shkoze, dt.12.11.2020;
- Shkrese e ASHK Drejtoria Vendore Korçë nr.4390, prot, date 26.10.2020.

Po ashtu, si prove ne gjykim eshte marre edhe dosja gjyqesore qe i perket vendimit penal te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçë nr.94, date 14.02.2017, me te gjitha aktet e ndodhura ne te.

Mbi kërkesën e paditësit, bazuar në nenin 224/a të K.Pr.Civile, gjykata vendosi kryerjen e një ekspertimi teknik me ekspert vlerësues të pasurive të paluajtshme (për të llogaritur vlerën e demit të shkaktuar objektit), duke caktuar me këtë cilësi inxhinierin e vlerësuesin Pandi Treska. Akti i ekspertimit i pergatitur nga eksperti Pandi Treska sipas detyrave te caktuara nga gjykata, eshte marre gjithashtu si prove ne gjykim.

I padituri Ledjan Shkëmbi nuk u paraqit ne asnje seance gjyqesore per te parashtruar pretendimet ne lidhje me kerkimet e paditesit sipas objektit te padise, pavaresisht se kishte dijeni, ndaj gjykimi vijoi ne mungese te kesaj pale, referuar nenit 179 te K.Pr.Civile.

Handwritten notes at the top right corner.

Handwritten notes in the middle left section.

Handwritten notes in the middle center section.

Handwritten notes in the middle right section.

Handwritten notes in the bottom left section.

Handwritten notes in the bottom center section.

Handwritten notes in the bottom right section.

